

REPUBLICA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA  
KESHILLI PROKURORIALI I KOSOVES - TUZHILACKI SAVETI KOSOVA  
SEKRETARIATI - SEKRETARIJAT  
ARKIVA - ARHIVA

Pranuar 08 -02- 2024 Priljeno

Numri rendor Redni broj	Ora e pranimit Cas prijema	Nenshkrimi pronesit Potpis primaoca
236		



**Republika e Kosoves**  
**Republika Kosovo/ Republic of Kosovo**  
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**  
**Prokuroria Themelore Prizren/ Osnovno Tužilaštvo Prizren/ Basic Prosecutor Prizren**

## RAPORTI VJETOR 2023

Punuan: Afërdita Salihu  
Laura Rakaj

**PRIZREN, janar 2024**

## Hyrje

Ky raport ofron informacion të përgjithshëm statistikor për punën e Prokurorisë Themelore në Prizren, natyrën e qarkullimit të lëndëve dhe vendosjes së tyre, përfshirë të gjitha lëndët nga të gjitha llojet e regjistrave në të tri departamentet: Departamentin e Krimeve të Rënda, Departamentin për të Mitur dhe Departamentin e Përgjithshëm.

Përveç punës së gjithëmbarshme, në këtë raport pasqyrohet puna e detajuar e secilit prokuror, duke prezantuar të dhënat për të gjitha lëndët nga të gjithë regjistrat si lëndët e trashëguara, lëndët e pranuar, lëndët e kryer dhe lëndët e mbetura në punë. Po ashtu në këtë raport pasqyrohen të dhënat mbi formën e kryerjes së lëndëve dhe marrjes së vendimeve nga ana e prokurorëve. Në raport do të jenë të pasqyruara, për secilin prokuror, natyra e përfundimit të lëndëve në gjykatë, duke përfshirë aktgjykimet dhe aktvendimet, ankesat e prokurorit, dhe Aktvendimet apo Aktgjykimet e shkallës së dytë.

Në raportin vjetor të Prokurorisë Themelore në Prizren, do të jetë mundësia e marrjes së informacioneve për lëndët e dhunës në familje, lëndët e dhunës në familje ku viktimat janë gratë, si dhe lëndët që kanë të bëjnë me veprat penale kundër integritetit seksual sipas kapitullit XX – të Kodit penal të Kosovës.

Po ashtu do të ketë të dhëna edhe për lëndët që hyjnë në mekanizmin përcjellës - lëndët e shënjestruara si lëndët e Korrupsionit, lëndët e krimeve ekonomike, lëndët që kanë të bëjnë import eksport furnizim transportim dhe shitje të pa autorizuar të armëve, nxitje të urrejtës, lëndët me narkotik, trafikim me qenie njerëzore dhe trafikimi me emigrant nga regjistrat PP dhe PPN.

Raporti përfshin edhe propozimet e prokurorëve për sekuestrim, ngrirje dhe konfiskim të pasurisë të përfutur me vepra penale, e gjithashtu do të jenë të pasqyruara edhe të dhënat statistike mbi kryerjen e lëndëve me procedurat alternative.

## *Përmbajtja*

I.Regjistri PP dhe PPM .....	4
1.1.Departmenti i Krimeve të Rënda, Regjistri PP.....	5-7
1.2.Pasqyra e punës së Prokurorëve të DKR-së .....	8-21
2.Departmenti për të mitur-Regjistri PPM.....	21-23
2.1.Regjistri PPN M.....	23
2.2.Pasqyra e punës së prokurorëve të DM.....	24-27
3. Departmenti i Përgjithshëm, Regjistri PP.....	27-30
3.1.Pasqyrë e punës së prokurorëve të DP-së.....	30-56
II. Regjistri PPN & PPNM.....	57
III. Regjistri PPP.....	57
IV. Regjistri NJN.....	57
V. Propozimet e prokurorëve për sekuestrim të përkohshëm, konfiskim dhe ngrirje të pasurisë .....	58
VI.Procedurat Alternative.....	59
VII.Të dhënat Statistikore lidhur me Dhunën në Familje.....	60-62
7.1 Të dhënat statistikore për dhunën në familje ku viktimat janë grate.....	62-63
VIII.Veprat penale kundër Integritetit Seksual.....	64-65
IX.Veprat penale të mekanizmit përcjellës – Regjistri PP.....	66-67
9.1.Veprat penale të mekanizmit përcjellës - Regjistri PPN.....	67-68
9.2. Rastet e Korrupsionit sipas prokurorëve.....	68-72

## I. REGJISTRI PP DHE PPM

Prokuroria Themelore në Prizren, nga vitet paraprake në fillim të vitit 2023 për personat madhor dhe të mitur, ka trashëguar gjithsej 600 kallëzime penale me 950 persona.

Gjatë periudhës Janar - Dhjetor të vitit 2023 kundër personave madhor dhe të mitur janë pranuar 2828 kallëzime penale me 3856 persona, që do të thotë se gjithsej në punë kanë qenë 3428 kallëzime penale me 4806 persona.

Gjatë këtij viti nga të gjitha departamentet janë kryer 2652 kallëzime penale me 3684 persona, dhe në fund të vitit 2023, në punë, kundër personave madhor dhe të mitur kanë mbetur 776 kallëzime penale me 1122 persona.

Tab. Nr. 1

REGJISTRI PP PPM	Të trashëguara		Të pranuar		Gjithsej në punë		Të kryera		Në punë	
	kall	pers.	kall	pers.	kall	pers.	kall	pers.	kall	pers.
Departamenti i Krimeve të Rënda	81	243	197	421	278	664	184	425	94	239
Departamenti i Përgjithshëm	461	642	2436	3100	2897	3742	2277	2947	620	795
Departamenti për të mitur	58	65	195	335	253	400	191	312	62	88
Gjithsej:	600	950	2828	3856	3428	4806	2652	3684	776	1122

Pranë Gjykatës Themelore në Prizren dhe degëve të kësaj gjykate, Degës së Suharekës dhe Degës së Dragashit, Prokurorët e Prokurorisë Themelore në Prizren kanë përfaqësuar dhe mbrojtur aktakuzat duke marrë pjesë në seanca gjyqësore dhe atë:

- ✓ Prokurorët e Departamentit të Krimeve të Rënda kanë mbrojtur aktakuzat në 773 seanca gjyqësore,
- ✓ Prokurorët e Departamentit për të Mitur kanë marr pjesë në 300 seanca gjyqësore,
- ✓ Prokurorët e Departamentit të Përgjithshëm kanë mbrojtur Aktakuzat në 5528 seanca gjyqësore

## **1.1 DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA – REGJISTRI PP**

Në këtë kapitull do të pasqyrohen lëndët e Departamentit të Krimeve të Rënda nga Regjistri PP, duke përfshirë numrin e lëndëve të trashëguara, numrin e lëndëve të pranuar, numrin e lëndëve të kryera– natyrën e kryerjes së tyre dhe numrin e lëndëve të mbetura në punë.

Po ashtu, përveç lëndëve të kryera dhe natyrës së kryerjes së tyre do të ofrohen statistika edhe mbi numrin e ankesave, numrin dhe llojin e aktvendimeve të Gjykatave Themelore dhe atyre të Gjykatës së Apelit.

Ndaj:

- Të trashëguara nga vitet paraprake në fillim të vitit 2023 janë 81 kallëzime penale me 243 persona
- Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2023 janë pranuar 197 kallëzime me 421 persona
- Që do të thotë se gjithsej në punë gjatë kësaj periudhe kohore kanë qenë 278 kallëzime penale me 664 persona.

Të trashëguara		Të pranuar		Gjithsej në punë	
Kallëzime	Persona	Kallëzime	Persona	Kallëzime	Persona
81	243	197	421	278	664

Gjatë Vitit 2023 në Departamentin e Krimeve të Rënda, janë përfunduar gjithsej 184 kallëzime penale me 425 persona.

Gjersa në punë në fund të vitit 2023 në DKR, kanë mbetur edhe 94 kallëzime penale me 239 persona.

Të përfunduara gjatë vitit 2023		Kanë mbetur në punë	
kallëzime	persona	kallëzime	persona
184	425	94	239

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2023 në Departamentin e Krimeve të Rënda nga numri i të gjitha kallëzimeve penale dhe personave që kanë qenë në punë janë zgjidhur në këtë mënyrë:

- janë parashtruar kërkesat për caktimin e paraburgimit në 56 kallëzime penale ndaj 93 personave, prej të cilave kërkesa janë aprovuar në 43 kallëzime penale ndaj 73 personave;
- janë hedhur 32 kallëzime penale ndaj 92 personave,
- kanë filluar hetimet në 109 kallëzime penale kundër 191 personave

- Janë pushuar hetimet në 15 kallëzime penale ndaj 40 personave
- Gjithsej janë ngritë 85 Aktakuza kundër 131 personave:
- Është kërkuar masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në një lëndë ndaj një personi
- Në kompetencë kanë shkuar 43 kallëzime penale me 130 persona,
- Në mënyrë tjetër – bashkëm i lëndëve 8 lëndë me 31 persona

#### Ankesat e prokurorëve lidhur me vendimet e gjykatës

- Në Aktgjykime të Gjykatës janë parashtruar ankesa në 74 lëndë ndaj 126 personave,
- prej tyre vetëm për dënim janë paraqitur 51 ankesa ndaj 58 personave:
- të aprovuara janë 13 ankesa ndaj 16 personave;
- të aprovuara për shkak të dënimit janë 7 ankesa me 8 persona;
- të refuzuara janë 58 ankesa me 95 persona
- të refuzuara për shkak të dënimit 45 ankesa 81 persona.

#### **Pasqyrë mbi mënyrën e përfundimit të lëndëve në DKR:**

Vendimet e prokurorit											Tab. nr. 4			
Kërkesë për caktimin e paraburgimit		të aprovuara		hurdhje		fillim i hetimeve		pushim i hetimeve		Aktakuzë pas hetimeve		të zgjidhura në mënyrë tjetër - cedim		
ka.	per	ka.	per	ka.	per	ka.	per	ka.	per	ka.	per	ka.	per	
56	93	43	73	32	92	109	191	15	40	55	131	51	161	

Ankesat										Tab. nr. 5			
Gjithsej ankesa të paraqitura		Ankesa vetëm për shkak të dënimit		Ankesa për arsye tjera		Gjithsej ankesa të aprovuara		Ankesa të aprovuara vetëm për dënim		Ankesa të refuzuara		ankesa të refuzuara vetëm për dënimin	
Ka.	Per.	Ka.	Per.	Ka.	Per.	Ka.	Per.	Ka.	Per.	Ka.	Per.	Ka.	Per.
74	126	51	58	23	68	13	16	7	8	58	95	45	81

### Vendimet e Gjykatës

- në 1 Aktakuzë ndaj 3 personave gjykata ka hedhur Aktakuzen
- në 1 aktakuz ndaj 1 personi gjykata ka marrë vendim për hudhje për shkak të vdekjes së të akuzuarit; dhe
- dhe në 2 Aktakuza ndaj 2 personave gjykata ka marr vendim për hudhje të aktakuzës për shkak të parashkrimit;
- Në 2 aktakuza ndaj 4 personave është marrë Aktgjykim Refuzues
- Në 19 aktakuza ndaj 29 personave është marrë Aktgjykim lirues
- Në 89 aktakuza ndaj 121 personave është marrë aktgjykim dënues

Tab.6

Vendimet e Gjykatës											
Hudhja e Aktakuzës		Hudhje për shkak të vdekjes		për shkak të parashkrimit		aktgjykim refuzues		Aktgjykim lirues		Aktgjykim dënues	
Ka.	Per.	Ka.	Per.	Ka.	Per.	Ka.	Per.	Ka.	Per.	Ka.	Per.
1	3	1	1	2	2	2	4	19	99	89	121

## 1.2. PASQYRË E PUNËS SË PROKURORËVE TË DEPARTAMENTIT TË KRIMEVE TË RËNDA

Në këtë pjesë do të pasqyrohen statistikat për secilin prokuror veç e veç, sa i përket lëndëve të trashëguara, të pranuar dhe të kryera gjatë periudhës JANAR – DHJETOR 2023 dhe lëndëve të mbetura në punë më 31 DHJETOR 2023, nëpër prokurorë të Departamentit të Krimeve të Rënda.

Përveç lëndëve, në këtë kapitull do të pasqyrohen edhe aktgjykimet dhe aktvendimet e gjykatës lidhur me aktakuzat e Prokurorisë, ankesat e parashtruara në vendime të gjykatës, si dhe do të prezentohen edhe vendimet e Gjykatës së Apelit.

Po ashtu, të dhënat do të jenë të secili prokuror edhe për lëndët nga regjistrat PPN, PPP, NJN dhe numrin e seancave vjetore në të cilat prokurorët kanë marrë pjesë.

Tab . 7

<i>DKR 2023</i>	<i>Genc Nixha</i>	<i>Ervehe Gashi</i>	<i>Metush Biraj</i>	<i>Mehdi Sefa</i>	<i>Nazan Shero</i>	<i>Arijana Shajkocaj</i>	<i>Sahide Sefa</i>	<i>Petrit Kryeziu</i>
<i>Të trashëguara</i>	16	18 <sup>1</sup>	19	11	4	8	6	0
<i>Të pranuar</i>	54	46	4	54	18	4	14	40
<i>Gjithsej në punë</i>	70	64	23	65	22	12	20	40
<i>Të kryera</i>	46	50	23	37	22	9	19	29
<i>Në punë</i>	24	21	0	28	0	3	1	11

### GENC NIXHA

#### Regjistri PP

- ❖ Nga vitet paraprake në fillim të vitit 2023 ka trashëguar 16 lëndë,
- ❖ Gjatë vitit 2023 i ka pranuar 54 lëndë
- ❖ Gjithsej në punë i ka pasur 70 lëndë
- ❖ Gjatë vitit 2023 i ka kryer 46<sup>2</sup> lëndë
- ❖ Në fund të vitit 2023 në punë i kanë mbetur 24 lëndë

<sup>1</sup> Prokurorja Ervehe Gashi në fund të muajit janar 2023 i ka raportuar 19 lëndë, ndërsa në muajin shkurt i ka bartur 26 lëndë, duke rritur kështu numrin për 7 lëndë, element ky që ka ndikuar në ndryshimin e lëndëve të mbetura në punë në fund të vitit 2023.

<sup>2</sup> Prokurori Genc Nixha me vendim përfundimtar i ka të kryera 41 lëndë, ndërsa 5 i ka të deleguara.



Lëndët e kryera gjatë vitit 2023 nga prokurori Gene Nixha kanë këto vendime:

Vendimi i prokurorit	kallëzimet	personat
- ndërprerje neni 231		
- pezullim neni 230		
- Hudhje me ndërmjetësim neni 232-		
- Hudhje	11	23
- transferim i procedurës		
- Në kompetencë	7	38
- të deleguara te prokuroret e DKR	6	
- Trajtim psikiatrik		
- Aktakuzë me Urdhër ndëshkimor		
- Aktakuzë pas hetimeve	19	23
- E zgjidhur në mënyrë tjetër	1	6
- Pushim i hetimeve	3	7
- Pezullim	2	2
- marrëveshje për pranimin e fajësisë	7	8
- Ankesa	15	29
- Për dënim	11	17
- ankesa të aprovuara		
- për dënim		
- ankesa të refuzuara	13	16
- për dënim	10	12
- Aktgjykime dënuese	12	15
- Aktgjykime refuzuese		
- Aktgjykime liruese	4	14
- Hudhje e Aktakuzës për shkak të vdekjes	1	1
- ankesë për hudhje		
- pjesëmarrja në seanca gjyqësore	158	

Në regjistrin PPN prokurori Gene Nixha për vitin 2023 ka këtë pasqyrë të lëndëve:

- nga viti paraprak ka trashëguar 90 lëndë
- gjatë vitit 2023 ka pranuar 104 lëndë
- gjithsej në punë ka pas 194 lëndë
- gjatë vitit 2023 ka kryer 54 lëndë
- dhe në fund të vitit 2023 në punë i kanë mbetur 140 lëndë PPN

**Në regjistrin PPP**, prokurori Genc Nixha për vitin 2023 ka këtë pasqyrë të lëndëve:

- nga viti paraprak ka trashëguar 147 lëndë
- gjatë vitit 2023 ka pranuar 51 lëndë përshfirë lëndët e Prokurorit Metush
- gjithsej në punë ka pas 198 lëndë
- gjatë vitit 2023 ka kryer 3 lëndë
- dhe në fund të vitit 2023 në punë i kanë mbetur 195 lëndë PPP.

## **ERVEHE GASHI**

### **Regjistri PP**

- ❖ Nga vitet paraprake në fillim të vitit 2023 ka trashëguar 25 lëndë.
- ❖ Gjatë vitit 2023 ka pranuar 46 lëndë
- ❖ Gjithsej në punë ka pas 71 lëndë
- ❖ Gjatë vitit 2023 ka kryer 50<sup>3</sup> lëndë
- ❖ dhe në fund të vitit 2023 ka të pakryera edhe 21 lëndë

**Lëndët e kryera gjatë vitit 2023 nga prokurori Ervehe Gashi, kanë këto vendime:**

Vendimi i prokurorit	kallëzimet	personat
ndërprerje neni 231		
- pezullim neni 230		
- Hudhje me ndërmjetësim neni 232-		
- Hudhje	10	25
- Aktakuzë e drejtpërdrejtë		
- Në kompetencë	17	37
- Te deleguara te prokurorët e DKR		
- Trajtim psikiatrik		
- Aktakuzë me Urdhër ndëshkimor		
- Aktakuzë pas hetimeve	15	20
- E zgjidhur në mënyrë tjetër	3	8
- Pushim i hetimeve	3	7
- Pezullim	2	2
- marrëveshje për pranimin e fajësisë	1	1
- pjesëmarrja në seanca gjyqësore	165	

<sup>3</sup> Prokurorja Ervehe Gashi me vendim përfundimtar i ka 48 lëndë, ndërsa 2 lëndë i ka të deleguara te prokurorët tjerë.

- Ankesa te parashtruara	12	19
- Për dënim	10	
- ankesa të aprovuara	2	2
- për dënim	1	1
- ankesa të refuzuara	10	25
- për dënim	9	24
- Aktgjykime dënuese	16	21
- Aktgjykime refuzuese	0	0
- Aktgjykime liruese	2	4
- Hudhje e Aktakuzës	1	3
- ankesë për hudhje	1	3
- Aprovim i ankesës për hudhje	1	3

**Në regjistrin PPN** prokurorja Ervehe Gashi për vitin 2023 ka këtë pasqyrë të lëndëve:

- nga viti paraprak ka trashëguar 30 lëndë
- gjatë vitit 2023 ka pranuar 122 lëndë
- gjithsej në punë ka pas 152 lëndë
- gjatë vitit 2023 ka kryer 102 lëndë
- dhe në fund të vitit 2023 në punë ka 50 lëndë PPN

**Në regjistrin PPP**, prokurorja Ervehe Gashi për vitin 2023 ka këtë pasqyrë të lëndëve:

- nga viti paraprak ka trashëguar 66 lëndë
- gjatë vitit 2023 ka pranuar 56 lëndë
- gjithsej në punë ka pas 122 lëndë
- gjatë vitit 2023 ka kryer 8 lëndë
- dhe në fund të vitit 2023 në punë ka 114 lëndë PPP

## **METUSH BIRAJ**

### **Regjistri PP**

- ❖ Nga vitet paraprake në fillim të vitit 2023 ka trashëguar 19 lëndë,
- ❖ Gjatë vitit 2023 ka pranuar 4 lëndë
- ❖ Gjithsej në punë ka pas 23 lëndë
- ❖ Gjatë vitit 2023 ka kryer 23<sup>4</sup> lëndë
- ❖ dhe në fund të vitit 2023 nuk ka asnjë lëndë në punë.

<sup>4</sup> Prokurori Metush Biraj ka kryer 6 lëndë PP me vendim përfundimtar, ndërsa 7 lëndë e ka deleguar tek prokurorët e tjerë.

Lëndët e kryera gjatë vitit 2023 nga prokurori Metush Biraj, kanë këto vendime:

Vendimi i prokurorit	kallëzimet	personat
- ndërprerje neni 231		
- pezullim neni 230		
- Hudhje me ndërmjetësim neni 232-		
- Hudhje	1	2
- Aktakuzë e drejtpërdrejtë		
- Në kompetencë	2	3
- Te deleguara te prokurorët e DKR		
- Trajtim psikiatrik		
- Aktkauzë me Urdhër ndëshkimor		
- Aktakuzë pas hetimeve	3	6
- E zgjidhur në mënyrë tjetër		
- Pushim i hetimeve	0	3
- Pezullim		
- marrëveshje për pranimin e fajësisë		
- pjesëmarrja në seanca gjyqësore	48	
- Ankesa	2	2
- Për dënim	2	2
- ankesa të aprovuara	1	1
- për dënim	1	1
- ankesa të refuzuara	2	3
- për dënim	2	3
- Aktgjykime dënuese	11	11
- Aktgjykime refuzuese	0	1
- Aktgjykime liruese		
- Hudhje e Aktakuzës		
- ankesë për hudhje		

**Në regjistrin PPN** për vitin 2023 prokurori, ka këtu pasqyrë të lëndëve:

- nga viti paraprak ka trashëguar 94 lëndë
- gjatë vitit 2023 ka pranuar 2 lëndë
- gjithsej në punë ka pas 96 lëndë
- gjatë vitit 2023 ka kryer 96<sup>5</sup> lëndë
- dhe në fund të vitit 2023 në punë ka 0 lëndë PPN

<sup>5</sup> Prokurori Metush Biraj gjatë vitit 2023 ka kryer 96 lëndë PPN, prej të cilave 80 lëndë i ka deleguar tek prokurorët tjerë, ndërsa 16 lëndë i ka kryer me vendim përfundimtar.

**Në regjistrin PPP**, për vitin 2023 ka këtë pasqyrë të lëndëve:

- nga viti paraprak ka trashëguar 143 lëndë
  - gjatë vitit 2023 ka pranuar 1 lëndë
  - gjithsej në punë ka pas 144 lëndë
  - gjatë vitit 2023 i ka deleguar të gjitha lëndët,
- dhe në fund të vitit 2023 në punë nuk ka asnjë lëndë.

**Në regjistrin NJN**, për vitin 2023 ka këtë pasqyrë të lëndëve:

- nga viti paraprak ka trashëguar 7 lëndë
- gjatë vitit 2023 nuk ka pranuar asnjë lëndë.
- gjithsej në punë ka pas 7 lëndë
- gjatë vitit 2023 i ka deleguar të gjitha lëndët.
- dhe në fund të vitit 2023 në punë nuk ka asnjë lëndë.

## **MEHDI SEFA**

### **Regjistri PP**

- ❖ Nga vitet paraprake në fillim të vitit 2023 ka trashëguar 11 lëndë,
- ❖ Gjatë vitit 2023 ka pranuar 54 lëndë
- ❖ Gjithsej në punë ka pas 65 lëndë
- ❖ Gjatë vitit 2023 ka kryer 37<sup>6</sup> lëndë
- ❖ dhe në fund të vitit 2023 ka të pakryera edhe 28 lëndë.

**Lëndët e kryera gjatë vitit 2023 nga prokurori Mehdi Sefa, kanë këto vendime:**

<b>Vendimi i prokurorit</b>	<b>kaliëzimet</b>	<b>personat</b>
- ndërprerje neni 231		
- pezullim neni 230		
- Hudhje me ndërmjetësim neni 232-		
- Hudhje	3	9
- Aktakuzë e drejtpërdrejtë	1	3
- Në kompetencë	12	31
- Trajtim psikiatrik		
- Aktakuzë me Urdhër ndëshkimor		
- Aktakuzë pas hetimeve	18	30
- E zgjidhur në mënyrë tjetër	1	2

<sup>6</sup> Prokurori Mehdi Sefa me vendim përfundimtar i ka të kryera 37 lëndë, të gjitha me vendim përfundimtar.

- Pushim i hetimeve	2	13
- Pezullim		
- të deleguara tek prokurorët tjerë		
- marrëveshje për pranimin e fajësisë	3	4
- pjesëmarrja në seanca gjyqësore	177 seanca	
- ankesa	26	57
- për dënim	18	43
- ankesa të aprovuara	6	9
- për dënim	3	4
- ankesa të refuzuara	21	37
- për dënim	17	33
- Aktgjykime dënuese	28	36
- Aktgjykime refuzuese	0	0
- Aktgjykime liruese	5	9
- Hudhje e Aktakuzës	0	0
- ankesë për hudhje	0	0

**Në regjistrin PPN** për vitin 2023 prokurori, ka këtë pasqyrë të lëndëve:

- nga viti paraprak ka trashëguar 74 lëndë
- gjatë vitit 2023 ka pranuar 105 lëndë
- gjithsej në punë ka pas 179 lëndë
- gjatë vitit 2023 ka kryer 125 lëndë
- dhe në fund të vitit 2023 në punë ka 55<sup>7</sup> lëndë PPN

**Në regjistrin PPP** për vitin 2023 ka këtë pasqyrë të lëndëve:

- nga viti paraprak ka trashëguar 113 lëndë
- gjatë vitit 2023 ka pranuar 54 lëndë
- gjithsej në punë ka pas 167 lëndë
- gjatë vitit 2023 e ka kryer 1 lëndë.
- dhe në fund të vitit 2023 në punë ka 166 lëndë

**Në regjistrin NJN** për vitin 2023 ka këtë pasqyrë të lëndëve:

- nga viti paraprak ka trashëguar 3 lëndë
- gjatë vitit 2023 nuk pranuar asnjë lëndë
- gjithsej në punë ka pas 3 lëndë
- gjatë vitit 2023 nuk ka kryer asnjë lëndë.
- dhe në fund të vitit 2023 në punë i kanë mbetur 3 lëndë

<sup>7</sup> Prokurori Mehdi Sefa në fund të muajit maj lidhur me lëndët PPN ka raportuar që i kanë mbetur në punë 67 lëndë, ndërsa në fillim të muajit qershor i ka bartuar 68 lëndë. Për këtë arsye ka mospërputhje numrin e lëndëve të mbetura në punë.

➤ **ARIJANA SHAJKOVCI**

**Regjistri PP**

- ❖ Nga vitet paraprake në fillim të vitit 2023 ka trashëguar 8 lëndë,
- ❖ Gjatë vitit 2023 ka pranuar 4 lëndë
- ❖ Gjithsej në punë ka pas 12 lëndë
- ❖ Gjatë vitit 2023 ka kryer 9<sup>8</sup> lëndë
- ❖ dhe në fund të vitit 2023 i ka të pakryera edhe 3 lëndë

Lëndët e kryera gjatë vitit 2023 nga prokurorja Arijana Shajkovci, kanë këto vendime:

Vendimi i prokurorit	kallëzimet	personat
- ndërprerje neni 231		
- pezullim neni 230		
- Hudhje me ndërmjetësim neni 232-		
- Hudhje	2	7
- Aktakuzë e drejtpërdrejtë		
- Në kompetencë	1	9
- Te deleguara te Prokuroret e DKR	0	
- Trajtim psikiatrik		
- Aktakuzë me Urdhër ndëshkimor		
- Aktakuzë pas hetimeve	3	4
- E zgjidhur në mënyrë tjetër	3	11
- Pushim i hetimeve	0	5
- Pezullim		
- marrëveshje për pranimin e fajësisë	2	3
- pjesëmarrja në seanca gjyqësore	49 seanca	
- Ankesa	1	1
- Për dënim		
- ankesa të aprovuara	0	0
- për dënim		
- ankesa të refuzuara	3	4
- për dënim	2	3
- Aktgjykime dënuese	1	1
- Aktgjykime refuzuese	0	0
- Aktgjykime liruese	1	1
- Hudhje e Aktakuzës		
- ankesë për hudhje		

<sup>8</sup> Prokurorja Arijana Shajkovci me vendim përfundimtar i ka të gjitha lëndët.

**Në regjistrin PPN** për vitin 2023 prokurori, ka këtë pasqyrë të lëndëve:

- nga viti paraprak ka trashëguar 19 lëndë.
- gjatë vitit 2023 ka pranuar 7 lëndë.
- gjithsej në punë ka pas 26 lëndë.
- gjatë vitit 2023 ka kryer 16 lëndë.
- dhe në fund të vitit 2023 në punë i ka 10 lëndë PPN.

**Në regjistrin PPP**, për vitin 2023 ka këtë pasqyrë të lëndëve:

- nga viti paraprak ka trashëguar 7 lëndë
- gjatë vitit 2023 ka pranuar 1 lëndë
- gjithsej në punë ka pas 8 lëndë
- gjatë vitit 2022 kryer 1 lëndë
- dhe në fund të vitit 2023 në punë ka 7 lëndë.

**Në regjistrin NJN**, për vitin 2023 ka këtë pasqyrë të lëndëve:

- nga viti paraprak ka trashëguar 4 lëndë
- gjatë vitit 2023 ka pranuar 40 lëndë
- gjithsej në punë ka pas 44 lëndë
- gjatë vitit 2023 ka kryer 37 lëndë
- dhe në fund të vitit 2023 në punë i kanë mbetur 8<sup>9</sup> lëndë.

## **PETRIT KRYEZIU**

### **Regjistri PP**

- ❖ Nga vitet paraprake nuk ka trashëguar asnjë lëndë.
- ❖ Gjatë vitit 2023 ka pranuar 40 lëndë
- ❖ Gjithsej në punë ka pas 40 lëndë
- ❖ Gjatë vitit 2023 ka kryer 29<sup>10</sup> lëndë
- ❖ dhe në fund të vitit 2023 ka të pakryera edhe 11 lëndë.

---

<sup>9</sup> Prokurorja Arjana Shajkoveci në fund të muajit nëntor ka raportuar se në punë i kanë mbetur 5 lëndë, ndërsa në fillim të muajit dhjetor ka deklaruar se të trashëguara i ka 6 lëndë, prandaj edhe kemi mospërputhje tek numri i lëndëve në punë.

<sup>10</sup> Prokurori Petrit Kryeziu i ka kryer 26 lëndë me vendim përfundimtar, ndërsa 3 lëndë i ka deleguar tek prokurorët tjerë.



Lëndët e kryera gjatë vitit 2023 nga prokurori Petrit Kryeziu, kanë këto vendime:

Vendimi i prokurorit	kallëzimet	personat
- ndërprerje neni 231		
- pezullim neni 230		
- Hudhje me ndërmjetësim neni 232-		
- Hudhje	8	15
- Aktakuzë e drejtpërdrejtë		
- Në kompetencë	3	3
- Trajtim psikiatrik		
- Aktakuzë me Urdhër ndëshkimor		
- Aktakuzë pas hetimeve	11	36
- E zgjidhur në mënyrë tjetër	4	6
- Pushim i hetimeve	0	2
- Pezullim		
- të deleguara tek prokurorët tjerë	3	
- marrëveshje për pranimin e fajësisë	1	1
- pjesëmarrja në seanca gjyqësore	61 seanca	
- ankesa	5	5
- për dënim	3	3
- ankesa të aprovuara	1	1
- për dënim	1	1
- ankesa të refuzuara	2	3
- për dënim	1	1
- Aktgjykime dënuese	4	5
- Aktgjykime refuzuese	0	0
- Aktgjykime liruese	0	0
- Hudhje e Aktakuzës	0	0
- ankesë për hudhje	0	0

**Në regjistrin PPN** për vitin 2023 prokurori, ka këtë pasqyrë të lëndëve:

- nga viti paraprak nuk ka trashëguar asnjë lëndë
- gjatë vitit 2023 ka pranuar 79 lëndë
- gjithsej në punë ka pas 79 lëndë
- gjatë vitit 2023 ka kryer 41<sup>11</sup> lëndë
- dhe në fund të vitit 2023 në punë ka 38 lëndë PPN

<sup>11</sup> Prokurori Petrit Kryeziu ka kryer 37 lëndë PPN me vendim përfundimtar, ndërsa 4 lëndë i ka deleguar tek prokurorët tjerë.

**Në regjistrin PPP** për vitin 2023 ka këtë pasqyrë të lëndëve:

- nga viti paraprak nuk ka trashëguar asnjë lëndë
- gjatë vitit 2023 ka pranuar 2 lëndë
- gjithsej në punë ka pas 2 lëndë
- gjatë vitit 2023 nuk ka kryer asnjë lëndë.
- dhe në fund të vitit 2023 në punë ka 2 lëndë

## **NAZAN SHERO**

Prokurorja Nazan Shero është prokurore në Departamentin për të Mitur, por sipas natyrës së lëndëve ajo kryen edhe lëndë të Krimeve të Rënda kur i/e mituri/a është i/e dëmtuar. Ndaj të dhënat e mëposhtme pasqyrojnë punën e saj vjetore sa i përket lëndëve të trashëguara, lëndëve të pranuar, lëndëve të kryera, formave dhe vendimeve të nxjerra lidhur me lëndët, Aktgjykimet dhe aktvendimet e gjykatës, ankesat e parashtruara në vendime, si dhe vendimet e Gjykatës së Apelit. Të dhënat do të jenë për numrin e lëndëve të mbetura në punë nga regjistri PP I dhe të dhënat për regjistrin PPN.

### **Regjistri PP I**

- ❖ Nga vitet paraprake në fillim të vitit 2023 ka trashëguar 4 lëndë,
- ❖ Gjatë vitit 2023 ka pranuar 18 lëndë
- ❖ Gjithsej në punë ka pas 22 lëndë
- ❖ Gjatë vitit 2023 ka kryer 22<sup>12</sup> lëndë
- ❖ dhe në fund të vitit 2023 nuk i ka mbetur asnjë lëndë.

**Lëndët e kryera gjatë vitit 2023 nga prokurorja Nazan Shero kanë këto vendime:**

Vendimi i prokurorit	kallëzimet	personat
- ndërprerje neni 231		
- pezullim neni 230		
- Hudhje me ndërmjetësim neni 232-		
- Hudhje		

<sup>12</sup> Prokurorja Nazan Shero sa i përket lëndëve PP në DKR, 11 lëndë i ka kryer me vendim përfundimtar, ndërsa 11 lëndë i ka deleguar tek prokurorët e tjerë, prej tyre në muajin dhjetor i ka deleguar 6 lëndë, për shkak të avancimit të saj në Prokurorinë e Apelit.

- Aktakuzë e drejtperdrejtë		
- Në kompetencë		
- Trajtim psikiatrik	1	1
- Aktakuzë me Urdhër ndëshkimor		
- Aktakuzë pas hetimeve	8	8
- E zgjidhur në mënyrë tjetër		
- Pushim i hetimeve	2	3
- Pezullim		
- të deleguara tek prokurorët tjerë	11	
- marrëveshje për pranimin e fajësisë		
- seanca gjyqësore	52	
- Ankesa	7	8
- Për dënim	4	5
- ankesa të aprovuara	0	0
- për dënim		
- ankesa të refuzuara	4	5
- për dënim	2	2
- Aktgjykime dënuese	5	6
- Aktgjykime refuzuese	0	
- Aktgjykime liruese	2	2
- Hudhje e Aktakuzës	0	
- ankesë për hudhje	0	

**Në regjistrin PPN I** për vitin 2023 prokurorja Nazan Shero, ka këtë pasqyrë të lëndëve:

- nga viti paraprak ka trashëguar 3 lëndë
- gjatë vitit 2023 ka pranuar 33 lëndë
- gjithsej në punë ka pas 36 lëndë
- gjatë vitit 2022 ka kryer 36<sup>13</sup> lëndë
- dhe në fund të vitit 2023 në punë nuk i ka mbetur asnjë lëndë.

## **SAHIDE SEFA**

Prokurorja Sahide Sefa, është prokurore në Departamentin për të Mitur, por, sipas natyrës së lëndëve ajo kryen edhe lëndë të Krimeve të Rënda kur i/e mituri/a është i/e dëmtuar. Ndaj të dhënat e mëposhtme pasqyrojnë punën e saj vjetore sa i përket lëndëve të trashëguara, lëndëve të pranuar, lëndëve të kryera, formave dhe vendimeve të nxjerra lidhur me lëndët, Aktgjykimet dhe aktvendimet e gjykatës, ankesat e parashtruara në vendime, si dhe vendimet e Gjykatës së Apelit.

<sup>13</sup> Prokurorja Nazan Shero në PPN të krimeve të rënda i ka deleguar 31 lëndë, ndërsa 5 lëndë i ka kryer me vendim.

Të dhënat do të jenë për numrin e lëndëve të mbetura në punë nga regjistri PP I, dhe të dhënat për regjistrin PPN.

### Regjistri PP I

- ❖ Nga vitet paraprake në fillim të vitit 2023 ka trashëguar 6 lende,
- ❖ Gjatë vitit 2023 ka pranuar 14 lëndë
- ❖ Gjithsej në punë ka pas 20 lëndë
- ❖ Gjatë vitit 2023 ka kryer 19<sup>14</sup> lëndë
- ❖ dhe në fund të vitit 2023 ka të pakryer edhe 1 lëndë

Vendimi i prokurorit	kallëzimet	personat
- ndërprerje neni 231		
- pezullim neni 230		
- Hudhje me ndërmjetësim neni 232-		
- Hudhje		
- Aktakuzë e drejtpërdrejtë		
- Në kompetencë	1	1
- Trajtim psikiatrik		
- Aktakuzë me Urdhër ndëshkimor		
- Aktakuzë pas hetimeve	7	7
- E zgjidhur në mënyrë tjetër		
- Pushim i hetimeve	5	6
- Pezullim		
- të deleguara tek prokurorët tjerë	6	
- marrëveshje për pranimin e fajësisë		
- numri i seancave gjyqësore	63	
- Ankesa	6	6
- Për dënim	3	3
- ankesa të aprovuara	2	2
- për dënim	1	1
- ankesa të refuzuara	3	3
- për dënim	2	2
- Aktgjykime dënuese	5	5
- Aktgjykime refuzuese	0	
- Aktgjykime liruese	3	3
- Hudhje e Aktakuzës	0	
- ankesë për hudhje	0	

<sup>14</sup> Prokurorja Sahide Sefa 13 lëndë i ka të kryera me vendim përfundimtar, ndërsa 6 lëndë i ka të deleguara tek prokurorët tjerët.

**Në regjistrin PPN I** për vitin 2023 prokurorja Sahide Sefa, ka këtë pasqyrë të lëndëve:

- nga viti paraprak ka trashëguar 1 lëndë
- gjatë vitit 2023 ka pranuar 32 lëndë
- gjithsej në punë ka pas 33 lëndë
- gjatë vitit 2023 ka kryer 33<sup>15</sup> lëndë
- dhe në fund të vitit 2023 në punë ka nuk ka asnjë lëndë PPN.

## **2 DEPARTAMENTI PËR TË MITUR – REGJISTRI PPM**

Në këtë kapitull do të pasqyrohen lëndët e Departamentit për të Mitur, nga Regjistrat PPM dhe PPN M. duke përfshirë lëndët e trashëguara, lëndët e pranuar, lëndët e kryer – natyra e lëndëve të kryera dhe lëndët në punë.

Po ashtu, përveç lëndëve të kryer dhe pasqyrimit të natyrës së kryerjes së tyre, do të ofrohen statistika edhe mbi numrin e Ankesave, numrin dhe llojin e Aktvendimeve të Gjykatës Themelore përfshirë dhe ato të Gjykatës së Apelit.

### **REGJISTRI PPM**

- ❖ nga vitet paraprake janë trashëguar 58 kallëzime me 65 persona.
- ❖ gjatë periudhës Janar -Dhjetor 2023 janë pranuar 195 kallëzime me 335 persona.
- ❖ gjithsej në punë në Departamentin për të Mitur kanë qenë 253 kallëzime me 400 persona.

tab. nr. 8					
Të trashëguara		Të Pranuar		Gjithsej në Punë	
Kallëzime	Persona	Kallëzime	Persona	Kallëzime	Persona
58	65	195	335	253	400

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2023 në Departamentin për të Mitur, janë kryer gjithsej 191 kallëzime penale me 312 persona.

Ndërsa në fund të periudhës raportuese në DM. në punë kanë mbetur edhe 62 kallëzime penale me 88 persona.

<sup>15</sup> Prokurorja Sahide Sefa në PPN të krimeve të rënda i ka deleguar 31 lëndë, ndërsa i ka kryer 2 lëndë me vendim.

DM – gjendja me lëndë		Tab. nr 9	
Të përfunduara		kanë mbetur në punë	
kallëzime	persona	kallëzime	persona
191	312	62	88

Në periudhën Janar – Dhjetor 2023 në Departamentin për të Mitur, nga numri i të gjitha kallëzimeve penale dhe personave që kanë qenë në punë, janë zgjidhur në këtë mënyrë:

- Është marrë aktvendim për fillimin e procedurës përgatitore në 113 kallëzime penale ndaj 203 personave,
- Në 11 kallëzime penale 12 personave është kërkuar paraburgimi, ndërsa është caktuar masa e paraburgimit në 9 lëndë me 9 persona.
- ka pushuar procedura përgatitore në 13 kallëzime penale ndaj 25 personave,
- 52 kallëzime janë hedhur ndaj 86 personave,
- Është kërkuar masa e diversitetit në 20 kallëzime penale ndaj 20 personave,
- Shqiptimi i masës së mbikëqyrjes së shtuar është propozuar në 80 kallëzime penale ndaj 125 personave,
- Është kërkuar masa institucionale në 13 kallëzime penale ndaj 17 personave,
- në mënyra tjera janë zgjidhur 12 kallëzime me 15 persona,
- është kërkuar shqiptimi i dënimit me burgim në 1 kallëzim penale ndaj 1 personi.

#### **Vendimet e gjykatës**

- në 4 lëndë ndaj 10 personave është marr aktvendim për pushimin e procedurës përgatitore
- në 34 lëndë ndaj 77 personave është kërkuar masa e qortimit për të miturit
- në 63 lëndë ndaj 87 personave është marr aktvendim për shqiptimin e masës edukative
- në 29 lëndë ndaj 30 personave është marr aktvendim për shqiptimin e masës institucionale,
- në 3 lëndë ndaj 3 personave është kërkuar dënimi me burgim
- në 1 lëndë ndaj 1 personi është kërkuar dënimi me kusht
- në 1 lëndë ndaj 1 personi është kërkuar urdhri për punë në dobi të përgjithshme.
- në 6 lëndë ndaj 6 personave është shqiptuar masa e trajtimit psikiatrik.

Vendimet e prokurorit										Tab. nr. 10	
Aktvendim për fillimin e procedurës përgaditore		Pushim i procedurës përgaditore		Hudhje		Masa e Diversitetit		Masë e mbikqyrjes së shtuar		Masë disiplinore	
ka.	per	ka.	per	ka.	per	ka.	per	ka.	pe	ka	pers
113	203	13	25	52	86	20	20	80	125	0	0

Vendimet e gjykatës														Tab. nr. 11	
Masa institucionale		të zgjidhura në mënyra tjera – Cëdim		Burgim		Aktvendim i Gjykatës për pushim		Aktvendim Shqiptimi i masës institucionale		Aktvendim –Masë edukuese		Aktgjykim dënues			
kall	pers	kall	pers	kall	pers	Ka	Per	Ka.	Per	Ka.	Per.	Ka.	Per		
13	17	12	15	1	1	4	10	29	30	63	87	45	88		

### Ankesat

Në vendimet e gjykatës janë parashtruar edhe ankesa dhe atë:

- në 11 vendime të gjykatës kundër 13 personave të mitur është parashtruar Ankesë
- për shkak të refuzimit të caktimit të paraburgimit 1 ankesë ndaj 1 personi dhe
- për arsye tjera është parashtruar 1 ankesë ndaj 2 personave
- Është aprovuar një ankesë ndaj një personi për arsye tjera
- Janë refuzuar 9 ankesa ndaj 13 personave
- Për dënim janë refuzuar 2-3.

### 2.1 REGJISTRI PPNM

- ❖ nga vitet paraprake janë trashëguar 43
- ❖ gjatë periudhës Janar -Dhjetor 2023 janë pranuar 93 lëndë
- ❖ gjithsej në punë kanë qenë 136 lëndë
- ❖ janë kryer 117 lëndë
- ❖ dhe në fund të vitit 2023 në Regjistrin PPNM në punë janë 19 lëndë.

## 2.2. PASQYRË E PUNËS SË PROKURORËVE TË DEPARTAMENTIT PËR TË MITUR

Në këtë pjesë do të pasqyrohen statistikat për secilën prokurorë të Departamentit për të Mitur, sa i përket lëndëve të trashëguara, të pranuar, dhe të kryera gjatë periudhës JANAR – DHJETOR 2023 dhe lëndëve të mbetura në punë më 31 DHJETOR 2023.

Përveç lëndëve, në këtë kapitull do të pasqyrohen edhe Aktgjykimet dhe aktvendimet e gjykatës lidhur me Propozimet e Prokurorisë, ankesat e parashtruara në vendime të gjykatës, si dhe vendimet e Gjykatës së Apelit.

Po ashtu të dhënat do të jenë të secilën prokurorë edhe për regjistrat PPN M, dhe numrin e seancave vjetore në të cilat prokuroret kanë qenë prezent.

Tab. 12

DM pasqyrë e punës së prokurorëve	Të trashëguara	Të pranuar	Gjithsej në punë ka pas	Të kryera	Në punë kanë mbetur
Sahide Sefa	19	113	132	99	33
Nazan Shero	36	86	122	122	0
Gjithsej	55	199	254	221	62 <sup>16</sup>

### NAZAN SHERO

#### Regjistri PPM

- ❖ Nga vitet paraprake në fillim të vitit 2023 ka trashëguar 36 lëndë,
- ❖ Gjatë vitit 2023 ka pranuar 86 lëndë
- ❖ Gjithsej në punë ka pas 122 lëndë
- ❖ Gjatë vitit 2023 ka kryer 122<sup>17</sup> lëndë
- ❖ dhe në fund të vitit 2023 nuk i ka mbetur asnjë lëndë në punë.

Lëndët e kryera gjatë vitit 2023 nga prokurorja Nazan Shero, kanë këto vendime:

Vendimi i prokurorit	kallëzimet	personat
- Propozim për mbikqyrje të shtuar	39	67
- Masa institucionale	9	9

<sup>16</sup> Prokurorja Nazan Shero i ka deleguar 29 lëndë në muajin dhjetor për shkak të avancimit të saj, ndërsa prokurorja Sahide Sefa këto lëndë do ti raportojë si të pranuar në muajin janar 2024.

<sup>17</sup> Prokurorja Nazan Shero i ka kryer 93 lëndë me vendim përfundimtar, ndërsa 29 lëndë i ka deleguar tek prokurorja Sahide Sefa.



- Pezullim	8	11
- <b>Hudhje</b>	<b>27</b>	<b>30</b>
- Hudhje me ndërmjetësim	7	13
- Hudhje-kundërvajtje	1	1
- Pushim i procedurës pergaditore	8	16
- Pushim me ndërmjetësim	3	3
- Në kompetencë	3	3
- E zgjidhur në mënyrë tjetër	0	0
- Diversitet	6	16
- Trajtim psikiatrik	0	0
- Burgim	1	1
- Qortim	0	0
- pjesëmarrja në seanca gjyqësore	164 seanca	
- Ankesa	4	4
- Për dënim	0	0
- ankesë e aprovuara	1	1
- ankesë e refuzuar	4	4
- për dënim	1	1
- masë institucionale	14	14
- masë edukative	34	55
- diversitet	0	
- pushim	4	4
- Trajtim psikiatrik	6	6
- Burgim	2	2
- Urdher per pune	1	1
- Qortim	18	35
- Dënim me kusht	1	1

### Regjistri PPN M

- ❖ Nga vitet paraprake në fillim të vitit 2023 ka trashëguar 21 lëndë.
- ❖ Gjatë vitit 2023 ka pranuar 44 lëndë
- ❖ Gjithsej në punë ka pasur 65 lëndë
- ❖ Gjatë vitit 2023 ka kryer 65<sup>18</sup> lëndë
- ❖ dhe në fund të vitit 2023 në regjistrin PPNM nuk ka asnjë lëndë të pakryer.

<sup>18</sup> Prokurorja Nazan Shero 57 lëndë PPN M i ka kryer me vendim përfundimtar, ndërsa 8 lëndë i ka të deleguara te prokurorja Sahide Sefa, e cila këto lëndë do ti raportoje si të pranuar në muajin janar 2024.

## SAHIDE SEFA

### Regjistri PPM

- ❖ Nga vitet paraprake në fillim të vitit 2023 ka trashëguar 22 lëndë,
- ❖ Gjatë vitit 2023 ka pranuar 113
- ❖ Gjithsej në punë ka pas 135 lëndë
- ❖ Gjatë vitit 2023 ka kryer 99 lëndë
- ❖ dhe në fund të vitit 2023 ka të pakryera edhe 33<sup>19</sup> lëndë

Lëndët e kryera gjatë vitit 2023 nga prokurorja Sahide Sefa, kanë këto vendime:

Vendimi i prokurorit	kallëzimet	personat
- Fillimi i procedurës pengaditore		
- Propozim për masë institucionale	6	9
- Mbikqyrje e shtuar	41	71
- Trajtim psikiatrik	0	0
- Pezullim	4	5
- Hudhje	34	63
- Hudhje me ndërmjetësim	26	54
- Pushim i procedurës pengaditore	7	15
- Pushim me ndërmjetësim	1	2
- Në kompetencë	3	3
- E zgjidhur në mënyrë tjetër	5	6
- Diversitet	3	3
- pjesëmarrja në seanca gjyqësore	140 seanca	
- Ankesa	7	9
- ankesë e aprovuara	0	0
- për dënim	0	0
- ankesë e refuzuar	5	9
- për dënim	1	2
- masë institucionale	11	14
- masë edukative	27	32
- diversitet	0	
- Hudhje – pushim i proc.	4	6
- Trajtim psikiatrik	0	
- Urdher per punë	0	
- Qortim	18	42

<sup>19</sup> Siç shihet edhe në të të dhënat statistikore, raporti ka mospërputhje në mes të lëndëve të përgjithshme dhe lëndëve të mbetura në punë, kjo për shkak se në muajin maj ka bërë ndryshime sa i përket lëndëve të trashëguara duke e zvogëluar numrin për 3 lëndë.

## Regjistri PPN M

- ❖ Nga vitet paraprake në fillim të vitit 2023 ka 22 lëndë të trashëguara,
- ❖ Gjatë vitit 2023 ka pranuar 49 lëndë
- ❖ Gjithsej në punë ka pas 71 lëndë
- ❖ Gjatë vitit 2023 ka kryer 61<sup>20</sup> lëndë
- ❖ dhe në fund të vitit 2023 në regjistrin PPNM ka të pakryera edhe 10 lëndë.

### 3. DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – REGJISTRI PP

Në këtë pjesë do të pasqyrohen lëndët e Departamentit të Përgjithshëm, nga Regjistri PP duke përfshirë lëndët e trashëguara, lëndët e pranuar, lëndët e kryer – natyra e lëndëve të kryera dhe numrin e lëndëve të cilat kanë mbetur në punë në fund të vitit 2023.

Po ashtu, përveç lëndëve të kryer dhe pasqyrimit të natyrës së kryerjes, do të ofrohen statistika edhe për numrin dhe llojin e Aktvendimeve të gjykatës së shkallës së parë, numrin e Ankesave të parashtruara dhe numrin e Aktvendimeve të Gjykatës së Apelit si shkallë e dytë.

-të trashëguara nga vitet paraprake në fillim të vitit 2023 kanë qenë 461 kallëzime me 642 persona,

-gjatë periudhës Janar – Dhjetor të vitit 2023 janë pranuar 2436 kallëzime me 3100 persona,

-gjithsej në punë në këtë Departament gjatë kësaj periudhe kanë qenë 2949 kallëzime me 3924 persona.

Tab.nr. 13

Të trashëguara		Të Pranuar		Gjithsej në Punë	
Kallëzime	Persona	Kallëzime	Persona	Kallëzime	Persona
461 <sup>21</sup>	642	2436	3100	2897	3742

Gjatë vitit 2023 në Departamentin e Përgjithshëm, janë përfunduar gjithsej 2277 kallëzime penale me 2947 persona.

<sup>20</sup> Prokurorja Sahide Sefa lëndët PPN M i ka kryer në këtë formë: 53 lëndë i ka kryer me vendim përfundimtar, ndërsa 8 lëndë i ka deleguar tek prokurorët e tjerë.

<sup>21</sup> Në fund të vitit 2022 në regjistrin PP në departamentin e përgjithshëm në punë kanë mbetur 429 lëndë, ndërsa tani në raportin e vitit 2023 jemi obliguar që të bartim si të trashëguara shifrën 461 lëndë, kjo për shkak se prokurori Musli Gashi në muajin prill ka shtuar 32 lëndë si të trashëguara më shumë nga muajt paraprak (për të cilin rast është njoftuar zyra e statistikave në Prokurorinë e Shtetit), duke ndikuar kështu në prishjen e balancimit të raportit të shkrimores. Prandaj jemi të vetëdijshëm se në rastin kur Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit të nxjerrë raport vjetor për departamentin e përgjithshëm të Prokurorisë Themelore në Prizren nuk do të ketë përputhje me këtë raport që ne e kemi përpiluar.

Ndërsa në punë në DP, kanë mbetur 620 kallëzime penale me 795 persona.

DP – gjendja me lëndë				Tab. nr. 14
Të përfunduara		kanë mbetur në punë		
kallëzime	persona	kallëzime	persona	
2277	2947	620	795	

Gjatë vitit 2023 në Departamentin Përgjithshëm, nga numri i të gjitha kallëzimeve penale dhe personave që kanë qenë në punë janë zgjidhur në këtë mënyrë:

- Në 292 kallëzime ndaj 325 personave janë parashtruar kërkesa për çaktimin e paraburgimit
- Në 243 kallëzime penale janë aprovuar kërkesat për 269 persona.
- janë hedhur 337 kallëzime penale ndaj 456 personave,
- Prej tyre në kundërvajtje kanë kaluar 30 kallëzime penale me 30 persona
- Hetimet kanë filluar për 1080 kallëzime penale kundër 1405 personave
- Pushim i hetimeve në 82 kallëzime penale ndaj 140 personave
- Gjithsej janë ngritë 1769 Aktakuza kundër 2247 personave. prej tyre:
- 964 Aktakuza pas hetimeve kundër 1239 personave
- 772 Aktakuza të Drejtpërdrejta kundër 963 personave
- 33 Aktakuzë me Urdhër Ndëshkimor kundër 45 personave
- Në kompetencë janë dërguar 54 kallëzime penale me 69 persona,
